



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

KONKURS PROJEKTIMI PËR KULLAT E VROJTIMIT

Termat e References

Për informacione të mëtejshme kontaktoni në adresën elektronike
kullatevrojtim@gmail.com

1. QËLLIMI DHE NATYRA E NDËRHYRJES

Agjencia Kombëtare e Bregdetit me qëllim promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike, si dhe identitetit dhe kulturës së zonave bregdetare, shpall konkursin universitar për projektimin e kullave vrojtuese përgjatë bregdetit shqipëtar.

Ky konkurs synon përfshirjen e departamenteve të projektimit dhe arkitektuës në të gjitha universitetet kombëtare me qëllim angazhimin dhe zhvillimin e talenteve studentore gjatë ndërtimit të strukturave bregdetare përgjatë gjithë territorit shqipëtar. Natyra e propozimeve do të prekë dhe hulumtojë mbi gjithë fazat e procesit të projektimit duke ofruar një projekt propozim të plotë dhe të gatshëm për zbatim.

2. VENDNDODHJA

Vendndodhjet e ndërhyrjeve do të jenë: Plazhi i Velipojës, Durrësit, Golemit, Vlorës, Dhërmiut dhe Sarandës. Shtrirja gjeografike do planifikohet në fazën e implementimit, gjatë të cilës do të përcaktohet numri i kullave si dhe hapësira e monitorimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

3. PRITSHMËRITË

3.1. përqasja me karakter vëndas

Të gjithë studentët priten të njohin karakterin vëndas të zonave të përcaktuara, i cili duhet të jetë baza kryesore e koncept-ideve. Duke u bazuar në kërkimet dhe tipologjitë e vëndeve të tjera, propozimet duhet të përshtasin karakterin vëndas me koncepte kontemporane për një produkt sa më original.

3.2. materializimi

Materialet që do të propozohen duhet të jenë ekologjike, të qëndrueshme dhe të kenë skema ndertimi dhe çmontimi në mënyrë që këto struktura të magazinohen gjatë sezonit të dimrit apo të transportohen përgjatë zonës bregdetare, në rast nevojë.

4. DATA TË RËNDËSISHME

05 Mars	Takimi me universitetet
10 Mars	Konfirmimi i grupeve të punës
12 Mars	Dorëzimi i detyrës së projektimit
12 Prill	Dorëzimi i projekt-propozimeve
15 Prill	Përzgjedhja e skuadrave nga juria
05 Maj	Prezantimi i projekteve fituese



5. PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

5.1. Programi


- 1) Hapësirë për 2 vrojtues
- 2) Hapësirë për set paisjesh për vrojtuesit
- 3) Hapësirë për paisje radio, ndërlidhëse
- 4) Hapësirë minimale për zhveshje dhe garderobë/depo

Në bazë të kërkimeve të tyre, skuadrat mund të propozojnë ndryshime në program, nëse këto ndryshime shoqërohen me një argumentim bindës.

5.2. Fletët grafike

- 1) Aksesueshmëria, qarkullimi dhe pikat e vrojtimit si trajektore
- 2) Katër (4) pamje teknike nga çdo anë e strukturës
- 3) Dy (2) prerje teknike
- 4) Një (1) planimetri e strukturës
- 5) Rendera, fotomontazhe
- 6) Relacion sqarues mbi projekt-idenë dhe konceptin lidhur me kontekstin vëndas
- 7) Relacion mbi materializimin e strukture
- 8) Preventiv duke u bazuar ne manualin e cmimeve mt
- 9) Maket, model 3d i strukture (preferencial)

Çdo skuadër duhet të dorëzojë një dokument A3 gjashtë (6) faqësh horizontal, ku të përfshihen gjithë materialet e mësipërme. Ky dokument duhet shoqëruar me një (1) faqe hyrëse me titullin, nëntitullin, autorët e projektit si dhe një imazh skicë ide apo inspirues i cili prezanton konceptin e projekt propozimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

6. SHPËRBLIMI I FITUESVE

Shpërblimi i fituesve do të jetë fillimisht ndërtimi i këtyre strukturave nën mbikqyrjen e vetë studentëve si dhe vlerësimi publik i projektit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit do ti dhurojë studentëve fitues një certifikatë falenderuese që vlerëson punën dhe përfshirjen e tyre në procesin e rivitalizimit të bregdetit shqiptar.

Një shpërblim monetar do të shpallet gjatë vazhdimësisë së konkursit.

7. DORËZIMI

Dorëzimi i dokumentit shtatë (7) faqësh PDF do të ndodhë online në adresën e e-mailit kullatevrojtim@gmail.com (max 20MB).

ose ndërmjet www.wetransfer.com, në të njëjtën adresë e-maili në rast se dokumenti i kalon 20MB.

Në rast se studentët preferojnë dorëzimin e dokumentit PDF në format A3 me CD, atëherë mund ta dorëzojnë në adresën:

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

Njësia e Projekteve

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 1

Tiranë, Shqipëri

DATA E DORËZIMIT: 12 PRILL 2014